



# EDUKIMI MJEDISOR



*Tetor 2024*

Edukimi mjedisor i ndihmon nxënësit të njihen me çështje të rëndësishme dhe jetike si: ujin, ajrin, tokën, natyrën, biodiversitetin. Ai është veprimtaria akademike dhe praktike, që përfshinë studimin sistematik të mjedisit dhe gjithë marrëdhënieve që e shoqërojnë; përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Përgjatë tyre nxënësit përfshihen emocionalisht dhe fizikisht; ata mësojnë për zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave të ndotjes, mbetjeve, energjisë, ekonomisë çarkulluese. Nxënësit përfshihen në mbrojtjen e natyrës dhe njëkohësisht e duan edhe më shumë atë.

**“E vetmja rrugë nëse do të përmirësojmë cilësinë e mjedisit,  
është përfshirja e të gjithëve”**

**Richard Rogers**

Mentorët e tyre, të cilët janë specialistët e edukimit mjedisor në të 12 AdZM-të e vendit mbështesin, përfshijnë dhe ndërmarrin nisma të përbashkëta me nxënësit, për përmirësimin e mjediseve të ndryshme. Në sajë të këtyre veprimtarive ata zhvillojnë shprehje dhe dije mjedisore, që i bëjnë të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme e të mençur. Përmes edukimit mjedisor nxënësit e niveleve të ndryshme akademike përfitojnë:

vetëdije dhe ndërgjegjësim për mjedisin dhe sfidat mjedisore

kuptojnë dhe analizojnë probleme dhe çështje shqetësuese mjedisore

motivohen dhe përfshihen për përmirësimin e cilësisë së mjedisit në nivel lokal dhe kombëtar

ndërmarrin nisma dhe veprimtari që synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit



Përmes këtij manuali mujor **Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura** paraqet aktivitetet e zhvilluara nga **12 Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura**, me nxënësit e shkollave të ndryshme në mbarë vendin dhe atyre që ndodhen pranë ZM-ve apo në zonat rurale, përgjatë muajit **tetor 2024**. Aktivitetet janë zhvilluar në kuadër të ditëve mjedisore, promovimit të zonave të mbrojtura, lojërave të ndryshme edukative dhe argëtuese në mjediset e shkollave apo në natyrë, duke synuar gjithëpërfshirjen e nxënësve të të dy gjinive, niveleve të ndryshme ekonomike dhe vendndodhjen gjeografike.

Nxënës të përfshirë **535**

**51** Shkolla të përfshira

Mësues të përfshirë **42**

**24** Specialistë të angazhuar

Orë mjedisore të realizuara **42**



# “EDUKIMI MJEDISOR”, SHKODËR

15 16 23



## 15 tetor 2024, Dita Botërore e Shpendëve Shtegtarë

“Dita Botërore e Shpendëve Shtegtarë” mbledhi së bashku në një orë mjedisore nxënës të shkollës 9-vjeçare “Nikë Luli” Kamicë dhe specialistët e AdZM-së Shkodër. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte njohja e nxënësve me shpendët shtegtarë që ndodhen në Rezervatin Natyror të Menaxhuar “Liqeni i Shkodrës”. Ky aktivitet u realizua nëpërmjet pikturave, dhe lojërave edukuese që specialistët zhvilluan me nxënësit.

## 16 tetor 2024, ecje në natyrë

AdZM Shkodër së bashku me profesorë dhe nxënës të shkollës së Mesme Pyjore “Kolë Margjini” realizuan një ecje përgjatë shtegut “Ura e Bunës - Mali i Taraboshit”, pjesë e Rezervatit Natyror të Menaxhuar “Liqeni i Shkodrës”. Një shteg i pasur me peizazhe të larmishme. Ky aktivitet eksplorues pasuroi njohuritë e nxënësve mbi vlerat e Rezervatit Natyror të Menaxhuar “Liqeni i Shkodrës”.

## 23 tetor 2024, dita e gështenjave

Nxënësit e shkollës “Rifat Nuzi” së bashku me specialistët e AdZM-së Shkodër organizuan një orë të hapur mjedisore. Ata zhvilluan një eskursion pranë Monumentit të Natyrës “Gështenjat e Reçit”. Nxënësit jo vetëm që u njohën me karakteristikat dhe vlerat e këtij pylli por edhe mblodhën gështenja të gjithë së bashku. Ky aktivitet promovoi vlerat e Monumentit të Natyrës “Gështenjat e Reçit” por edhe nxiti kujdesin që nxënësit duhet të kenë për ruajtjen e parqeve dhe pyjeve që vendi ynë ka.

shpendë shtegtarë

krijimtari

ecje në natyrë





# “EDUKIMI MJEDISOR”, KUKËS



## 12 tetor 2024, ecje në natyrë

Në kuadër të edukimit mjedisor me shkollat, stafi i AdZM-së Kukës në bashkëpunim me shkollën 9-vjeçare “Dragobi” zhvilluan një aktivitet eksplorues siç është ecja në natyrë në shtegun “Dragobi-Valbonë”. Vërshtirësia e shtegut ishte mesatar, gjatësia e shtegur 7.2 km, kohëzjatja 2.5 orë, lartësia minimale 535 m, lartësia maksimale 785 m. Eksplorimi i këtij shtegu ishte një eksperiencë e paharrueshme për nxënësit pasi ata shijuan natyrën magjike që ofron Parku Kombëtar “Alpet e Shqipërisë”.

## 24 tetor 2024, orë mjedisore

Specialistët e AdZM Kukës në bashkëpunim me shkollën 9-vjeçare “Konferenca e Bujanit” zhvilluan një orë mjedisore jashtë ambjenteve të shkollës në kuadër të Ditës së Gështenjave. Nxënësit u njohën për vlerat, karakteristikat dhe rëndësinë ekonomike të gështenjave.





## 7 tetor 2024, Dita Botërore e Habitaveve

AdZM Dibër në bashkëpunim me shkollën 9-vjeçare “Selim Alliu”, realizoi një orë mjedisore në kuadër të Ditës Botërore të Habitaveve. Nxënësit u njohën me rëndësinë e ruajtjes së habitateve natyrore dhe biodiversitetit e cila siguron ekosisteme të shëndetshme. Këto aktivitete mund të ndihmojnë nxënësit të kuptojnë më thellë rëndësinë e habitatit dhe mjedisit, duke iu ofruar atyre mundësi të mësuarit përmes veprimit, diskutimeve dhe aktiviteteve krijuese.



## 4 tetor 2024, orë mjedisore

Në kuadër të Ditës Botërore të Kafshëve, specialistët e AdZM Lezhë zhvilluan me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Fran Ivanaj” një orë mjedisore. Në këtë aktivitet nxënësit u njohën me karakteristikat e rrëqebullit të Ballkanit si dhe me problematikat që has mbrojtja e kafshëve. Gjithashtu ata zhvilluan pyetësor të ndryshëm mbi informacionet e marra me qëllim për të përvetësuar njohuritë si dhe për të zhvilluar të menduarit aktiv.

## 7 tetor 2024, aktivitet mjedisor

Në kuadër të edukimit mjedisor specialistët e AdZM Lezhë zhvilluan një aktivitet mjedisor në ditën Botërore të Habitave të bashku me nxënësit e shkollës 9- vjeçare “Besëlidhja”. Kjo ditë na bën të reflektojmë se të gjitha gjallesat kanë nevojë për një vend ku të jetojnë, të rriten, të ushqehen dhe të shumohen. Pa diskutim nuk mungojnë dhe lojërat dhe aktivitetet krijuese të ndryshme në klasë ku nxënësit realizojnë punime në lidhje me temën që diskutohet. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte nxitja e përgjegjshmërisë tek të rinjtë për qëndrueshmërinë e habitave.

## 14 tetor 2024, Dita Ndërkombëtare për Uljen e Fatkeqësive Natyrore

Specialistët e AdZM Lezhë së bashku me nxënësit e shkollës së mesme të përgjithshme “Ishull” kanë zhvilluar një aktivitet mjedisor në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për Uljen e Fatkeqësive Natyrore. Fillimisht u diskutua me fëmijët mbi dëmet që sjellin përmytjet dhe zjarret në pyje, më pas u prezantuan me disa nga mjetet e përdorura për fikjen e zjarreve, këshillat dhe udhëzimet që duhen të ndiqen në rast të shfaqjes së zjarreve. Qëllimi i aktivitetit ishte ndërgjegjësimi për angazhim dhe veprim i gjithsecilit nga ne, në mënyrë që të parandalohen rreziqe me pasoja të mëdha.



## 16 tetor 2024, Dita Ndërkombëtare e Shpendëve Shtegtarë

Shpendët shtegtarë janë krijesa të mrekullueshme me aftësi dhe sjellje të jashtëzakonshme që na ndihmojnë të kuptojmë më mirë ndërveprimin e jetës dhe të mjedisit. Ruajtja e këtyre specieve është thelbësore për balancën ekologjike dhe biodiversitetin e planetit tonë. Në kuadër të kësaj dite, specialistët e AdZM Lezhë zhvilluan me nxënësit e shkollës së mesme të përgjithshme "Ishull" Lezhë një aktivitet të hapur mjedisor. Fillimisht nxënësit u njohën me karakteristikat e shpendëve shtegtarë dhe më pas grumbulluan gjethe shumëngjyrëshe dhe krijuan me to shpendë të ndryshëm.

---

## 21 tetor 2024, ekspeditë mjedisore

Stafi AdZM Lezhë zhvilloj një ekspeditë mjedisore në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Veprimit për Klimën së bashku me të rinjtë e Qendrës Rinore H.A.N.A dhe organizata rinore Espoir 18 me mbështetje të RYCO në Shqipëri dhe Solidarite Laique në Francë - si pjesë e programit Jeunes des 2 Rives. Në fillim u zhvillua një vizitë në qendrën e vizitorëve "Vain" ku u njohën me biodiversitetin e larmishëm të zonës. Më pas me anë të dylbive dhe teleskopit vëzhguan faunën e egër si dhe në fund zhvillua një shëtitje përgjatë lagunës me biçikleta.

# “EDUKIMI MJEDISOR”, FIER



## 12 tetor 2024, Dita Botërore e Shpendëve,

Parku Kombëtar “Divjakë-Karavasta” është një mjedis natyror shumë i rëndësishëm për shpendët shtegtarë, për këtë arsye të gjithë së bashku duhet të kujdesemi për këtë shtëpi të madhe natyrore, jo vetëm në një ditë të vitit, por çdo ditë. AdZM Fier së bashku me Junior Ranger dhe nxënës nga shkolla të ndryshme eksploran dhe studioan shtegun e pelikanit.

## 22 tetor 2024, orë mjedisore

AdZM Fier së bashku me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Pinellopi Pirro", zhvilluan një orë mjedisore. Fillimisht nxënësit u njohën me vlerat e parkut dhe më pas zhvilluam një bashkëbisedim për Ditën Botërore të Ushqimit.

## 28 tetor 2024, aktivitet krijues

Specialistët e AdZM Fier në bashkëpunim me shkollën 9-vjeçare “Germenj” Divjakë zhvilluan një orë mjedisore për njohjen e vlerave natyrore të Parkut Kombëtar “Divjakë-Karavasta”. Nxënësit nëpërmjet vizatimeve dhe ngjyrosjeve mësuam më shumë rreth llojeve kryesore të florës dhe faunës si dhe vlerat që ato kanë.

eksplorim

vizitë

krijimtari



# “EDUKIMI MJEDISOR”, DURRËS



## 4 tetor 2024, Dita Botërore e Kafshëve

Në kuadër të Ditës Botërore të Kafshëve, AdZM Durrës zhvilloi në shkollën 9- vjeçare “Hamallaj”, një sesion informues me nxënësit e klasave të 3 – ta. Nxënësit fillimisht mësuan mbi rëndësinë e kësaj dite. Dita Botërore e Kafshëve shënohet çdo vit më 4 tetor për të ritur ndërgjegjësimin për ruajtjen e kafshëve në të gjithë globin. Sesioni u zhvillua në dy faza, ku në fazën e parë nxënësit u njohën me disa nga llojet kryesore të faunës së Parkut Natyror “Qafështamë”. U diskutua mbi metodat e vrojtimit dhe mbrotjes së tyre, mbi moratoriumin e gjuetisë si dhe mësuan rreth kamerave kurth, dylbive etj. Në fazën e dytë nxënësit identifikuan llojet kryesore dhe ngjyrosën me lapsa me ngjyra speciet e faunës së parkut duke përmendur edhe disa karakteristika të tyre.

## 7 tetor 2024, Dita Botërore e Habitaveve

Specialistët e AdZM Durrës në kuadër të kësaj dite, organizuan një aktivitet në natyrë me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Selman Ali Xaka”. Aktiviteti u zhvillua në natyrë, në territorin e PN “Qafështamë”. Kjo është një ditë që na bën të reflektojmë se të gjitha gjallesat kanë nevojë për një vend ku të jetojnë, të rriten, të ushqehen dhe të shumohen. Në formën e bashkëbisedimit specialistët dhe nxënësit diskutuan mbi habitatet dhe llojet e tyre. Si edhe ata u njohën me rëndësinë e ruajtjes së habitateve dhe çfarë mund të ndodhë me faunën e florën nëse habitatet shkatërrohen nga faktorë të ndryshëm. Nxënësit krijuan habitate të vogla me materiale të marra nga natyra.



## 16 tetor 2024, Dita Botërore e Ushqimit

Dita Botërore e Ushqimit është një ditë ndërkombëtare që festohet çdo vit në mbarë botën më 16 tetor, ditën e themelimit të FAO-s, Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë në vitin 1945. Ushqimi është nevoja e tretë më themelore e njeriut pas ajrit dhe ujit. Të gjithë duhet të kenë të drejtën për ushqim të mjaftueshëm. Për të patur një jetë të shëndetshme ne duhet të ushqehemi shëndetshëm. Specialistët e AdZM Durrës në kuadër të kësaj dite realizuan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës "Qazim Zenel Tepshi" në Krujë. Ata krijuan një piramidë ushqimore. Nxënësit përmes aktivitetit mësuuan se piramida e ushqimit të shëndetshëm paraqet grupet ushqimore dhe sasi të relative të ushqimit që duhet të konsumohet.

---

## 22 tetor 2024, sesion informues

AdZM Durrës zhvilloi një sesion informues me nxënësit e klasës së shtatë të shkollës 9-vjeçare "Perlat" në Durrës. Tema e përzgjedhur ishte "Pyjet, rëndësia dhe roli i tyre". Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti ishte edukimi mjedisor në mënyrë që nxënësit të krijojnë një raport të ri me natyrën dhe të ndjekin parimin e sjelljes miqësore me mjedisin. Gjithashtu nxënësit mbollën disa fidanë ullinj në mjediset përreth shkollës.

---

## 30 tetor 2024, punim me gjethe vjeshte

Në bashkëpunim me kopshtin "Varosh" Krujë, AdZM Durrës realizoi një aktivitet me fëmijët në kuadër të edukimit mjedisor. Fëmijët e kopshtit "Varosh" në Krujë mblodhën gjethe të formave e ngjyrave të ndryshme për të krijuar me to punime mjaft të bukura. Ata jo vetëm krijuan lloje të faunës dhe pemë të ndryshme me gjethe por arritën dhe të identifikonin llojet e krijuara si përshebull fluturat, peshkun, iriqin, pemët etj.

# “EDUKIMI MJEDISOR”, TIRANË



## 4 tetor 2024, Dita Botërore e Kafshëve

Në këtë ditë AdZM Tiranë në bashkëpunim me shkollën e mesme të bashkuar “Shëngjergj” zhvilloi një orë mjedisore. Aktiviteti u zhvillua me nxënësit e klasës së 6 dhe 7. Në këtë aktivitet nxënësit u njohën me rëndësinë që kanë kafshët e egra në ekosistem. Gjatë orës mjedisore, nxënësit morën pjesë në një lojë ku indentifikuan kafshët, duke theksuar kështu rëndësinë e ruajtjes së biodiversitetit. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte njohja me faunën e egër të parkut dhe si dhe ndarjen e tyre sipas rënditjes taksonomike.

## 7 tetor 2024, Dita Botërore e Habitaveve

Specialistët e AdZM Tiranë zhvilloi në shkollën 9-vjeçare “Vesel Tila”, ShënMëri një orë mjedisore në kuadër të Ditës Botërore të Habitaveve. Aktiviteti u zhvillua me nxënësit e klasës së 9-të, ata u njohën me rëndësinë e habitateve, llojet dhe funksionet e tyre në natyrë si dhe kujdesi që ne duhet të kemi për këto habitate. Gjatë kësaj ore mjedisore nxënësit krijuan dhe një terrarium të mbyllur, për të krijuar kështu një mjedis të plotë jetese. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte rritja e njohurive të të rinjve mbi rëndësinë dhe llojet e habitateve si dhe ndërgjegjësimin e tyre për ruajtjen dhe përkujdesin ndaj tyre.

## 17 tetor 2024, në shkollën 9-vjeçare "Albanët"

Specialistët e AdZM Tiranë zhvilluan një orë mjedisore me temë "Pjesët e një bime dhe funksioni që ato kanë". Kjo orë mjedisore u zhvillua me nxënës të dy klasave të treta. Gjatë bashkëbisedimit nxënësit mësuan rreth bimëve, karakteristikave të ndryshme dhe rolit të tyre në natyrë. Më pas ata u angazhuan në një eksperiment për të kuptuar transportimin e ujit në bimë, duke aplikuar metoda praktike dhe interactive. Nxënësit patën mundësinë të eksploronin natyrën më nga afër, duke identifikuar dhe prekur pjesët e bimëve përmes një loje edukative. Kjo përvojë u pasua më pas me krijimin e posterave, duke zhvilluar aftësitë e tyre krijuese dhe duke vënë në praktikë njohuritë e fituara. Në fund të kësaj ore të bukur dhe me plot aktivitete nxënësit u shpërblyen me çertifikata, për angazhmin mjedisor dhe përkushtimit ndaj mbrojtjes së natyrës. Ky aktivitet ishte një hap i rëndësishëm në promovimin e mbrojtjes së natyrës dhe edukatës mjedisore mes të rinjve.

---

## 7 tetor 2024, Dita Ndërkombëtare e Veprimtarisë për Klimën

Në kuadër të kësaj dite, specialistët e AdZM Tiranë zhvilluan një aktivitet mjedisor në bashkëpunim me shkollën 9-vjeçare "Vilë-Boshtovë", pjesë e Parkut Kombëtar "Divjak-Karavasta". Ky aktivitet u zhvillua me nxënës të klasës së tetë. Nxënësit dhanë kontributin e tyre në pastrimin e zonës së plazhit të Vilë-Boshtovës, duke ndihmuar kështu në ruajtjen e biodiversitetit. Aktiviteti kishte si qëllim ndërgjegjësimin e të rinjve, se si një mjedis i pastër ndikon dretpërsëdrejti në një klimë të ekuilibruar.





## 4 tetor 2024, Dita Botërore e Kafshëve

Në Ditën Botërore të Kafshëve, specialistët e Adzm Berat zhvilluan një orë edukimi mjedisor me nxënësit e shkollës “Muhamet Kondi”. Ky aktivitet synoi ndërgjegjësimin dhe edukimin e nxënësve mbi mirëqënien e kafshëve dhe mbrojtjen e tyre. Pas njohjes me kafshët specifike të zonave të mbrojtura, nxënësit patën mundësi të përfshihen dhe të zhvillojnë më shumë njohuritë e tyre rreth kafshëve dhe habitateve të tyre.

## 7 tetor 2024, Dita Botërore e Habitaveve

Në kuadër të Ditës Botërore të habitateve u zhvillua nga specialistët e AdZM Berat një orë edukimi mjedisor në shkollën “70 Vjetori i Pavarësisë”. Gjatë kësaj ore nxënësit kishin mundësi të njihen dhe të reflektojnë mbi gjendjen e habitateve tona dhe mbi të drejtën themelore e të gjithëve për strehim të përshtatshëm. Qëllimi i Ditës Botërore të Habitaveve është t’i kujtojë botës përgjegjësitë e saj për të ardhmen e habitateve njerëzore të qëndrueshme mjedisore. Një ditë që na bën të reflektojmë se të gjitha gjallesat kanë nevojë për një vend që të rriten, të jetojnë dhe të shumohen.

## 8 tetor 2024, Dita Ndërkombëtare për Zvogëlimin e Fatkeqësive Natyrore

Në kuadër të kësaj dite është zhvilluar nga specialistët e AdZM Berat një orë edukimi mjedisor në shkollën 9-vjeçare në Fushë-Peshtan. Në këtë aktivitet edukues u diskutua lidhur me fatkeqësitë natyrore, ndikimet, mundësia e parashikimit apo e zvogëlimit të tyre. Nxënësit ndanë eksperiencat dhe shembujt e tyre nga zonat ku banojnë.

## 24 tetor 2024, Dita Ndërkombëtare e Veprimit për Klimën

Specialistët e AdZM Fier, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Veprimit për Klimën, realizuan një orë mjedisore në shkollën 9 vjeçare “Fasli Salianj” në Vodicë. Gjatë këtij aktiviteti u diskutua rreth ndryshimeve klimatike, faktorët që ndikojnë si dhe pasojat që vijnë nga ndryshimet klimatike.

# “EDUKIMI MJEDISOR”, KORÇË



## 9 tetor 2024, orë mjedisore

Specialistët e AdZM Korçë në bashkëpunim me shkollën “Sevasti Qirjazi”, organizuan një orë mjedisore me rreth 25 nxënës të klasës së pestë. Gjatë këtij aktiviteti mjedisor u shpjegua mbi habitatet dhe biodiversitetin e zonave të mbrojtura. Aktiviteti u finalizua me disa habitate të krijuara nga nxënësit sipas imagjinatës së tyre.

## 15 tetor 2024, orë mjedisore

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Ecjes në Natyrë, AdZM Korçë në bashkëpunim me shkollën “14 Ëngjëjt” ka realizuar një ecje me nxënësit e klasave të 8-ta dhe të 9-ta, përgjatë shtegut “Dardhas-Guri i Kamjes” me gjatësi 4 km. Nxënësit u njohën me monumentin e natyrës “Guri i Kamjes” si edhe me larmishmërinë e biodiversitetit përgjatë këtij shtegu. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte njohja dhe eksplorimi i natyrës nga vetë nxënësit duke nxitur tek ta dashurinë për natyrën e mrekullueshme që na rrethon.

## 30 tetor 2024, aktivitet në natyrë

Në kuadër të muajit të gështenjave AdZM Korçë së bashku me nxënësit e shkollës “Kozma Basho” në Pogradec, përshkuan shtegun për tek pylli i gështenjave. Nxënësit u argëtuan duke mbledhur gështenja dhe duke marrë informacione për rëndësinë e këtij pylli dhe vlerat e këtij fruti. Në fund të këtij aktiviteti nxënësit u njohën me vlerat e frutit të gështenjës.

habitat      monument natyre      shteg për këmbësorët

vlera natyrore      ecje në natyrë



# “EDUKIMI MJEDISOR”, ELBASAN



## 4 tetor 2024, Dita Botërore e Kafshëve

Specialistët e AdZM Elbasan, së bashku me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Isuf Gjura", realizuan një orë mjedisore në kuadër të "Ditës Botërore të Kafshëve", ditë në të cilën vëmendja kthehet drejt tyre dhe si një formë ndërgjegjësimi për mbrojtjen dhe kujdesin që duhet të tregojmë ndaj kafshëve. Gjatë kësaj ore nxënësit u njohën me rëndësinë e tyre në ruajtjen e ekuilibrit ekologjik në planetin tonë. Gjithashtu, vogëlushët e kësaj shkolle, krijuan një kënd ilustrues të kafshëve, duke bërë dallimin dhe ndarjen e tyre sipas mjedisit ku jetojnë, nëpërmjet fotove dhe vizatimeve të ndryshme.

## 7 tetor 2024, Dita Botërore e Habitaveve

Në kuadër të "Ditës Botërore të Habitaveve", specialistët e AdZM Elbasan, realizuan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës së mesme të bashkuar "Shefqet Dosku" Dorëz, pjesë e Parkut Kombëtar "Shebenik. Gjatë kësaj ore, nxënësit u njohën me pasuritë natyrore dhe kulturore të parkut Parku Kombëtar "Shebenik", i cili ka një pasuri të madhe përsa i përket larmishmërisë së florës. Bimësia në park është mjaft e pasur, duke filluar që nga ato barishtore, shkurrore e deri te ato drunore. Specialistët e AdZM Elbasan, prezantuan një material me temën kushtuar habitaveve të parkut, ku nxënësit mësuan rreth bimësisë dhe llojeve të ndryshme që gjenden në këtë zonë të mbrojtur. Gjithashtu, nëpërmjet disa herbariumeve, ata arritën të identifikojnë disa prej tyre.

flora dhe fauna  
ambient i pastër

aktivitet pastrimi  
dita botërore e ushqimit



## 8 tetor 2024, aksion pastrimi

Specialistët e AdZM Elbasan realizuan një aktivitet mjedisor, siç është ai i pastrimit, në bashkëpunim me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Shaban Leka". Nisma të tilla shërbejnë për të edukuar dhe ndërgjegjësuar brezin e ri, si dhe për të përcuar tek ta dashurinë dhe dëshirën për ta mbrojtur natyrën dhe ambientin ku jetojmë.

## 16 tetor 2024, Dita Botërore e Ushqimit

Data 16 tetor në mbarë botën konsiderohet si "Dita Ndërkombëtare e Ushqimit". Në bashkëpunim me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Veiz Çota" Togëz, u realizua një orë mjedisore në kuadër të kësaj dite, gjatë së cilës, ata u njohën me vlerat dhe rëndësinë e ushqimit si një nga faktorët jetikë në jetën tonë. Në një kënd, të krijuar së bashku me nxënësit, u bë ndarja e disa prej llojeve të ndryshme të ushqimeve në të shëndetshme dhe të pashëndetshme. Në fund, ata dhanë edhe mesazhin e rëndësishëm "Të ushqehemi shëndetshëm".

## 17 tetor 2024, orë mjedisore

Specialistët e AdZM Elbasan realizuan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës së mesme të bashkuar "Afëz Berbiu", në afërsi të Parkut Kombëtar "Mali i Tomorrit" Gjatë kësaj ore u njohën me vlerat natyrore dhe mjedisore të parkut, si edhe me florën dhe faunën e kësaj zone të mbrojtur.

## 23 tetor 2024, Aktivitet argëtues me fëmijët

Orë mjedisore nga specialistët e AdZM Elbasan me vogëlushët e kopshtit "1 qershori" Librazhd. Gjatë kësaj ore fëmijët organizuan një panair me frutat e stinës dhe produkteve që përftoheshin prej tyre. Ata mësuan për rëndësinë që frutat kanë në dietën tonë të përditshme dhe vlerat e tyre ushqyese. Në një kënd, vogëlushët realizuan disa punime interesante dhe shumë tërheqëse me gjethet shumëngjyreshe të vjeshtës.

## 24 tetor 2024, Dita Ndërkombëtare e Veprimeve për Klimën

Në kuadër të kësaj dite, specialistët e AdZM Elbasan realizuan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Ramazan Bala" Xibrakë. Gjatë kësaj ore nxënësit u njohën me temën, e cila ishte "Dita Ndërkombëtare e Veprimeve për Klimën". Ata mësuan rreth faktorëve që ndikojnë në këtë fenomen, i cili po bëhet gjithmonë e më shqetësues në mbarë botën si edhe mënyrën se si ne mund të ndikojmë në parandalimin e këtij fenomeni. Orët mjedisore kanë si qëllim përcjelljen e informacionit, bazuar në temën e përzgjedhur për ta.

## 28 tetor 2024, Vlerat natyrore dhe mjedisore në Rezervatin Natyror të Menaxhuar "Stravaj-Sopot"

Specialistët e AdZM Elbasan në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës së mesme e bashkuar "Ahmet Elezi" Stravaj, zhvilluan një orë mjedisore për njohjen e vlerave të Rezervatit Natyror të Menaxhuar "Stravaj-Sopot". Tema e trajtuar nga stafi i AdZM Elbasan ishte "Vlerat natyrore dhe mjedisore në Rezervatin Natyror të Menaxhuar "Stravaj-Sopot". Nxënësit u njohën me vlerat natyrore dhe mjedisore të rezervatit, si edhe me florën e faunën e tij, duke identifikuar disa lloje bimësh dhe kafshësh.

## 29 tetor 2024, Vlerat natyrore dhe mjedisore në Rezervatin Natyror të Menaxhuar Polis

Në kuadër të njohjes së vlerave natyrore dhe mjedisore të Rezervatit Natyror të Menaxhuar Polis, specialistët e AdZM Elbasan në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës 9-vjeçare "Babje" zhvilluan një orë mjedisore. Tema që trajtua nga stafi i AdZM Elbasan ishte "Vlerat natyrore dhe mjedisore në Rezervatin Natyror të Menaxhuar Polis". Nxënësit u njohën me vlerat natyrore dhe mjedisore të rezervatit, si edhe me florën e faunën e tij, duke identifikuar disa lloje bimësh dhe kafshësh.

# “EDUKIMI MJEDISOR”, GJIROKASTËR



## 14 tetor 2024, orë mjedisore

AdZM Gjirokastër në bashkëpunim me qendrën “Xhuzepe Grass” në kuadër të Ditës Botërore të Shpendëve Shtegëtarë ka zhvilluar një orë mjedisore me fëmijët parashkollorë. Fëmijët mësuan duke krijuar me gjethe shpendë të ndryshëm. Aktiviteti kishte qëllim ndërgjegjësimin për mbrojtjen e shpendëve migrator dhe habitatet e tyre.

## 24 tetor 2024, Dita Ndërkombëtare e Veprimeve për Klimën

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për Klimën, AdZM Gjirokastër zhvilloi një orë të edukimit mjedisor në shkollën 9 vjecare “Kamber Bënja” ku u fol për qëndrueshmërinë dhe aftësinë adaptuese ndaj rreziqeve të lidhura me klimën dhe fatkeqëitë natyrore si edhe strategjitë edhe planifikimin kombëtar.



# “EDUKIMI MJEDISOR”, VLORË

23



## 23 tetor 2024, orë mjedisore

Në kuadër edukimit mjedisor, specialistët e AdZM-së Vlorë organizuan një orë mjedisore në bashkëpunim me Universitetin “Ismail Qemali” Fakulteti i Shkencave të Natyrës. Studentët u informuan mbi folezimin e breshkës detare. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte sensibilizimi i rinjve mbi rëndësinë e mjedisit natyror dhe mbrojtjen e këtyre specieve të rrezikuara. Ky lloj aktiviteti është shumë i rëndësishëm për ruajtjen e biodiversitetit dhe mbrojtjen e specieve të rrezikuara, si breshkat detare, të cilat ndodhen në rrezik për shkak të ndryshimeve klimatike, ndotjes dhe shkatërrimit të habitatit të tyre.